



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Misioni në Kosovë

Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

PËRFAQËSIMI LIGJOR NË RASTET CIVILE

QERSHOR 2007

TABELA E PËRMBAJTJES

FJALORTH.....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I. Hyrje.....	5
II. Sistemi i ndihmës ligjore në Kosovë dhe ndikimi i mungesës së mbrojtësve në rastet civile	5
III. Autorizimet e pavlefshme për përfaqësim	9
IV. Konfliktet e interesave dhe jo-përshtatshmëria e avokatëve	12
V. Ushtrimi i dobët i detyrave nga ana e përfaqësuesve ligjor	13
VI. Përfundim.....	17
VII. Rekomandime	17

Fjalorth

AER	Agjencia Evropiane për Rikonstruim
DD	Departamenti i Drejtësisë
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KSAK	Krahina Socialiste Autonome e Kosovës
LPK	Ligji mbi Procedurën Kontestimore
LPJK	Ligji mbi Procedurën Jo-Kontestimore
OAK	Oda e Avokatëve e Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UNMIK (orig)	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Avokatët mbrojtës, sikurse gjyqtarët dhe prokurorët, luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e drejtësisë në secilin sistem juridik. Përmes mbrojtjes së shkathët, përqendrimit të vëmendjes në detaje dhe profesionalizmit, avokatët mbrojnë interesat e klientëve të tyre dhe sigurojnë që ligji të respektohet nga gjykatat, prokurorët dhe avokatët tjerë.

Ky raport fokusohet në problemet që kanë të bëjnë me përfaqësimin ligjor në rastet civile në Kosovë të identifikuara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). I njëjti paraqet vazhdimësi të Shqyrtimit të parë gjithëpërfshirës të OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Civile në Kosovë, i cili ishte publikuar në qershor të vitit 2006.

Së pari, OSBE adreson problemin se në Kosovë nuk ekziston një sistem funksional për ndihmë ligjore në rastet civile, gjë që mund të shkel të drejtat për përfaqësim ligjor efektiv dhe falas në rastet civile, siç është paraparë me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Së dyti, raporti fokusohet në problemet që kanë të bëjnë me kompetencat e mbrojtësve. OSBE-ja është e brengosur për shfrytëzimin e autorizimeve të pavlefshme të mbrojtësit të cilat krijohen shpesh përmes përdorimit të dokumenteve të falsifikuara për kryerjen e transaksioneve të rrejshme pronësore. Në mënyrë tipike, palët e dëmtuara në këto transaksione të rrejshme janë minoritetet të cilët ishin zhvendosur pas konfliktit dhe kishin braktisur pronat e tyre.

Së fundi, OSBE adreson problemin që ka të bëjë me atë se disa mbrojtës shkelin Kodin e Etikës Profesionale të Avokatëve. OSBE ka vështruar shkelje etike në lidhje me ushtrimin e dobët të detyrës nga ana e avokatëve, përfaqësimin e klientëve përkundër konflikteve të dukshme të interesave dhe veprimet që nuk janë në përputhshmëri me profesionin e tyre. Veçanërisht shqetësues është përfaqësimi i dobët ligjor në rastet ku avokatët përfaqësojnë palët në mungesë ose palët të cilët nuk janë në dijeni për zhvillimin e procedurës gjyqësore.

Në përfundim, OSBE ofron një numër rekomandimesh që për qëllim kanë korrigjimin e këtyre mangësive. OSBE inkurajon autoritetet relevante t'i zbatojnë këto rekomandime dhe të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të përmirësuar të metat e nënvizuara.

I. Hyrje

Avokatët mbrojtës, sikurse gjyqtarët dhe prokurorët, luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e sundimit të ligjit. Ata, duhet t'i promovojnë interesat e klientëve të tyre duke i ofruar atyre mbrojtje me përkushtim të duhur, si dhe mund të ndihmojnë që të sigurohet se gjykatat, prokurorët dhe avokatët tjerë përfillin ligjin. Ky raport përqendrohet në problemet e identifikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)¹ që kanë të bëjnë me përfaqësim ligjor në rastet civile.

Edhe pse e drejta në avokat dhe mbrojtje efektive në raste tipike ndërlidhet me rastet penale, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), nën rrethana të kufizuara, ekziston e drejta për mbrojtje efektive dhe falas edhe për rastet civile.

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, Kosova nuk ka një sistem funksional të ndihmës ligjore për rastet civile dhe shumica e palëve përfaqësojnë vetveten, madje edhe kur ata nuk janë në gjendje që plotësisht të kuptojnë procedurat apo t'i mbrojnë interesat e veta. Pasi që palët rrallë herë kuptojnë ose përcjellin procedurën civile, rastet civile duken kaotike dhe shpeshherë seancat duhen të shtyhen për shkak se palët nuk paraqiten apo vijnë të papërgatitur.

Një tjetër problem i vërejtur nga OSBE-ja është përdorimi i autorizimeve të pavlefshme të avokatit, të cilat shpesh krijohen përmes shfrytëzimit të dokumentave të falsifikuar dhe gjyqtarët civil shpesh nuk i zbulojnë ato.

Përfundimisht, OSBE është e brengosur se disa avokatë e shkelin Kodin e Etikës Profesionale të Avokatëve (Kodi i Etikës)² përmes ushtrimit të dobët të detyrës, konflikteve të interesave dhe veprimeve që janë inkompatibile me profesionin e tyre.

II. Sistemi i ndihmës ligjore në Kosovë dhe ndikimi i mungesës së mbrojtësve në rastet civile

Edhe pse shprehimisht nuk është e përmendur në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj),³ praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka përcaktuar se, nën rrethana të kufizuara, e drejta e qasjes në gjykatë, kërkon ndihmë ligjore falas për rastet civile. Sipas GjEDNj-së, e drejta në ndihmë ligjore falas për çështjet civile ekziston si pjesë e së drejtës për qasje efektive në gjykatë në rastet ku përfaqësimi ligjor është i obligueshëm sipas ligjit vendor ose, kur për shkak të ndërlikueshmërisë së llojit të rastit palët nuk mund t'i mbrojnë interesat e tyre në mënyrë efektive pa ndihmën e një

¹ Në bazë të mandatit të vet, Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik (SMSJ) pjesë e Departamentit për të Drejtat e Njeriut, Demokratizim dhe Komunitete të Misionit të OSBE-së në Kosovë, monitoron sistemin juridik në Kosovë në mënyrë që të sigurojë përputhshmëri të tij me standardet vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe rekomandon zgjedhje të qëndrueshme që të siguroj se këto standarde po respektohen. Pas monitorimit të sistemit të drejtësisë penale që nga viti 1999, në janar të vitit 2005 OSBE filloi të monitoroj sistemin e drejtësisë civile, duke njohur rëndësinë që një sistem ligjor funksional civil/komercial ka për gjyqësorin dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë.

² Aprovuar nga Asambleja e Odës së Avokatëve të Kosovës më 11 qershor 2005.

³ Neni 6.1 i KEDNj-së i referohet të drejtës në mbrojtje falas dhe efektive vetëm për rastet penale.

profesionisti ligjor.⁴ Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, faktorët relevant për përcaktimin e së drejtës në ndihmë ligjore falas në rastet civile janë, domosdoshmëria që të adresohen pikat e ndërlikueshme të ligjit dhe të përcaktohen faktet që përfshijnë dëshmitë e ekspertit dhe të dëshmitarëve si dhe, të përcaktohet se a kërkon lloji i kontestit në mënyrë tipike përfshirje emocionale që nuk është në përputhje me shkallën e objektivitetit që kërkohet për mbrojtje gjyqësore.⁵

Ligji i aplikueshëm mbi Procedurën Kontestimore në Kosovë (LPK)⁶ nuk ofron në mënyrë eksplicite të drejtën në përfaqësim nga avokati, por në disa rrethana për të drejtën në ndihmë ligjore nga një “autorizues” i cili mund të jetë qdo person me zotësi veprimi⁷ LPK rregullon që “ Në qoftë se pala nuk është në gjendjetë deklarohet qartë e në mënyrë të caktuar mbi objektin rreth të cilit bëhet shqyrtimi, kurse nuk ka autorizues, kryetari i kolegjit do t’ia theksojë nevojën e angazhimit të autorizuesit. LPK obligon gjykatën, kur vërtetohet se nuk është avokat, nuk është i zoti ta kryej këtë detyrë, gjykata do ti theksojë palës pasojat e dëmshme që mund ti lindin për shkak të përfaqësimit jo të drejtë.”⁸

Përderi sa LPK nuk rregullon në mënyrë eksplicite të drejtën në përfaqësues ligjor në rastet civile, siq është diskutuar më lartë, praktika gjyqësore e GjeDNj-së duke interpretuar të drejtën e qasjes në gjykata dhe Nenin 6 të KEDNj rregullon të drejtën në përfaqësim ligjor në disa raste civile. Për shembull, kjo e drejtë egziston kur palët apo autorizuesit e tyre nuk mund të mbrojnë në mënyrë efektive interesat e palëve për shkak të ndërlikueshmërisë apo natyrës së rastit.

Ndërmjet korrikut 2001 dhe gushtit 2005, sistemi për ndihmë ligjore në Kosovë u ofroi banorëve me të ardhura të vogla ndihmë ligjore falas në rastet civile dhe administrative. Një marrëveshje e lidhur në vitin 2001 në mes të Agjencisë Evropiane për Rikonstruim (AER) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), krijoi Projektin

⁴ Në rastin *Airey kundër Irlandës*, duke analizuar shkëljen e të drejtës së aplikuesit për qasje në Gjykatën e Lartë, me qëllim që të kërkoj një vendim për ndarje ligjore, GjEDNj përcaktoi se, përkundër mungesës së dispozitës në nenin 6.1 mbi ndihmë ligjore për konteste civile, kjo dispozitë “ndonjëherë mund t’i detyroj Shtetet të ofrojnë ndihmë përmes avokatit kur një ndihmë e tillë dëshmon të jetë e domosdoshme për një qasje efektive në gjykata, ose për shkak se përfaqësimi ligjor është i obligueshëm siç parashihet me ligjin vendor të disa shteteve kontraktuese për disa çështje të ndryshme gjyqësore, ose për arsye të ndërlikueshmërisë së procedurës apo të rastit.” (Shih vendimin e GjEDNj-së mbi rastin *Airey kundër Irlandës*, 9 tetor 1979, para. 26 *in fine*). Në një jurisprudencë më të vonshme, Gjykata gjithashtu ka rikujtuar se “[p]arimi kyq i cili qeveris zbatimin e nenit 6 është korrektësia” dhe se “[e]kziston rëndësia që të sigurohet dukja e administrimit të drejtë të drejtësisë dhe pala duhet të jetë në gjendje të merr pjesë në mënyrë efektive, inter alia, duke qenë i/e aftë t’i adresoj çështjet për të mbështetur kërkesën e vet. Këtu [...], serioziteti mbi çështjen që është me rëndësi për aplikuesin do të jetë relevante që ai/ajo të vlerësoj përshtatshmërinë dhe korrektësinë e procedurës.” (*P., C dhe S. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj, 16 korrik 2002, para. 91); shih gjithashtu rastin e *A. B. kundër Sllovakisë*, ku Gjykata gjeti se: duke dështuar të merr një vendim mbi kërkesën e aplikuesit për caktimin e mbrojtësit, autoritetet vendore kanë privuar aplikuesin nga mundësia që ta prezantoj rastin e saj nën kushtet e barabarta vis-a-vis me të paditurin (*A.B kundër Sllovakisë*, GjEDNj, 4 mars 2003, para. 61).

⁵ Për shembull në disa konteste martesore (*Airey kundër Irlandës*, GjEDNj, 9 tetor 1979, para.26, dhe *McVicar kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj, 7 maj 2002, para.49), dhe kontestet për përkujdesje të fëmijëve (*P.,C, dhe S kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj, 16 korrik 2002, para. 95).

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ)Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90 dhe 35/91.

⁷ Neni 90.1 LPK

⁸ Neni 90.4 LPK

për Ndhimë Ligjore të cilin AER-i e zgjati për çdo vit deri në gusht të vitit 2005. Për shkak të përfundimit të këtij projekti, sistemi për ndihmë ligjore në rastet civile dhe administrative ka pushuar të funksionuar në Kosovë. Disa organizata joqeveritare (OJQ) ende vazhdojnë të ofrojnë ndihmë ligjore falas banorëve me të ardhura të vogla në kategori të kufizuara ose anëtarve të grupeve të ndjeshme.⁹

Megjithatë, përkundër mundësisë për ndihmë ligjore në disa raste civile në Kosovë, ndihma ligjore nuk është e siguruar për të gjithë banorët, në të gjitha regjionet, për të gjitha llojet e rasteve civile.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/36 mbi Ndhimën Ligjore, e miratuar më 7 qershor 2006, mbulon zbrazësinë e krijuar me përfundimin e Projektit për Ndhimë Ligjore. Rregullorja parasheh sistemin për ndihmë ligjore si për rastet penale ashtu edhe për ato civile. Në bazë të nenit 9, ndihma ligjore parësore dhe dytësore në rastet civile përfshinë përfaqësimin ligjor në kontestet e ndarjes, shkurrëzimit dhe ligjit mbi familjen, padive pronësore/banesore, kontesteve të punës që kanë të bëjnë me shkarkime të gabuara dhe për procedurat ku përfshihen të miturit dhe personat me aftësi të kufizuara. Në bazë të nenit 11, ata të cilët kanë të drejtën në ndihmë parësore ligjore përfshijnë të gjithë personat e “kualifikuar”¹⁰ të cilët marrin ose kanë të drejtën të marrin ndihmë sociale ose janë në gjendje të ngjashme ekonomike. Ndhimja dytësore ligjore mund t’i ofrohet të gjithë personave të ardhurat familjare totale të së cilëve janë më të vogla se ato mesatare dhe të cilat janë të pamjaftueshme të mbulojnë shërbimet ligjore.¹¹ Zyra e Qarkut për Ndhimë Ligjore e paraparë sipas nenit 6, është përgjegjëse të siguroj dhënie të ndihmës ligjore, si dhe pranon dhe vendos mbi aplikacionet për ndihmë ligjore. Kur aprovohet, Zyra e udhëzon aplikuesin tek dhënësi i caktuar ndihmës ligjore, p.sh. avokatët në shërbim nga lista e qarkut, klinikat për ndihmë ligjore ose OJQ-të.¹²

Fatkeqësisht, Rregullorja nuk është zbatuar tërësisht dhe si pasojë kjo ka shkaktuar që nga gushti 2005 në Kosovë të mos ketë në një sistem funksional për ndihmë ligjore në rastet civile. Deri në mars 2007, Zyra e Kryeministrit ende nuk ka caktuar të gjithë anëtarët e Komisionit për Ndhimë Ligjore¹³ i cili administron dhe monitoron sistemin për ndihmë ligjore. Për më tepër Zyra Ko-ordinuese për Ndhimë Ligjore (sekretariati i komisionit) dhe Zyra e Qarkut për Ndhimë Ligjore nuk janë themeluar ende. Ky

⁹ OJQ-ja spanjolle *Movimiento por la Paz, el Desarme y la Libertad* (MPDL) e vendosur në Prishtinë, u ofron ndihmë ligjore falas refugjatëve, personave të zhvendosur dhe të kthyerve; OJQ-ja Programi për të Drejtat Civile, Kosovë (PDC/K) në Prishtinë u ofron ndihmë ligjore falas të zhvendosurve, refugjatëve, të kthyerve dhe minoriteteve në rrezik të zhvendosjes; OJQ-ja *Programmes d’Aide et de Developpement destines aux Enfants du Monde* (PADEM) e vendosur në pjesën veriore të Mitrovicës u ofron të zhvendosurve ndihmë ligjore falas në lidhje me të drejtat pronësore; OJQ-ja Kodi, Asociacioni për Ndhimë Ligjore për Femrat në Pejë, ofron ndihmë ligjore falas në rastet civile për femrat dhe pjesëtarët e minoriteteve (kryesisht komunitetit Boshnjak); OJQ-ja *Medica Mondial* ofron ndihmë ligjore falas në rastet civile për femrat në Gjakovë; Asociacioni i Avokatëve Norma ofron ndihmë ligjore falas në rastet civile për banorët me të ardhura të vogla përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara si dhe pjesëtarët e minoriteteve në Prishtinë.

¹⁰ Personat në vijim janë të “kualifikuar” të pranojnë ndihmë ligjore: banorët e përhershëm të Kosovës, banorët e përkohshëm të Kosovës që vijnë nga juridiksionet që ofrojnë ndihmë ligjore reciproke për banorët e përhershëm të Kosovës dhe personat e tjerë të përcaktuar me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare, shih nenin 10, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006.36 mbi Ndhimë Ligjore.

¹¹ Standardet e sakta për kualifikim financiar do të të përcaktohen sipas udhëzimit administrativ i cili deri më sot nuk është lëshuar.

¹² Neni 6, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/36 mbi Ndhimë Ligjore.

¹³ Neni 4, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/36 mbi Ndhimë Ligjore.

dështim në krijimin e sistemit funksional për ndihmë ligjore në rastet civile përbën shkelje të ligjit vendor dhe është e mundur edhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

OSBE ka vërejtur probleme shtesë në rastet civile të shkaktuara si pasojë e përfundimit të Projektit për Ndihmë Ligjore para themelimit të sistemit të ri për ndihmë ligjore. Sipas gjyqtarëve të intervistuar nga ana e OSBE-së, në disa raste, avokatët të cilët nuk paguheshin më nga AER ndaluan së marruri pjesë në dëgjimet gjyqësore dhe i dhanë fund përfaqësimit të klientëve të tyre.

Bazuar në Kodin e Etikës, duke i braktisur klientët, avokatët kanë shkelur detyrimet e veta morale. Neni 85 i cili thotë, “[d]hënia falas e ndihmës ligjore për njëriëzit në rrezik social ose njëriëzit nevojtar është një detyrim prestigjioz i avokatëve mbrojtës.” Veç kësaj, neni 86 thotë se “[m]brojtësi është i detyruar t’i përfaqësoj në rastet civile dhe penale personat në rrezik social.” Përfundimisht, mbrojtësi, “[n]uk mund ta revokoj autorizimin për përfaqësim, përveç në rastet e parapara me [K]od, në bazë të së cilit ai është [...] i autorizuar të refuzoj ndihmën ligjore.”¹⁴ Edhe pas përfundimit të marrëdhënies mbrojtës/klient, avokati është i obliguar ta përfaqësoj palën edhe për 30 ditë ose ti jap kohë klientit deri sa të angazhon ndonjë avokat tjetër, cilado nga këto të dyja të vij e para.¹⁵

Përderisa mospranimi i pagave në përgjithësi mund të konsiderohet si bazë e arsyeshme për përfundimin e shërbimeve ligjore, kjo nuk është e rradhitur si arsye e pranueshme nën nenin 24 të Kodit të Etikës dhe gjithashtu bie në konflikt me obligimin për përfaqësim të banorëve të Kosovës me të ardhura të vogla. Veç kësaj, edhe kur revokimi është i justifikuar, mbrojtësi duhet të respektoj periudhën prej 30 ditëve siç është paraparë me nenin 29 të Kodit të Etikës në mënyrë që t’i lejoj klientit të gjej përfaqësim tjetër.

Sistemi i tanishëm jo-funksional për ndihmë ligjore në rastet civile, sipas KEDNj-së, mund të shkel të drejtën e palës në mbrojtje sepse ua mohon banorëve me të ardhura të vogla qasjen në drejtësi, ka ndikim negativ në procedurën gjyqësore si dhe shkakton vonesa të panevojshme të rastit.

Pa përfaqësim ligjor nga avokati palët në konteste civile shpesh nuk i kuptojnë aspektet substanciale apo procedurale të rasteve.¹⁶ Për shkak të mungesës së trajnimit ligjor, palët që përfaqësojnë vetveten zakonisht nuk i përfillin rregullat procedurale dhe pengojnë seancat për të bërë pyetje. Gjyqtarët kanë vështirësi të mirëmbajnë rregullin gjatë seancave përgatitore dhe atyre gjyqësore, dhe jo-ligjorët ndonjë herë

¹⁴ Neni 28, Kodi i Etikës. Neni 24 rradhit bazat mbi të cilat mund të refuzohet ofrimi i shërbimeve ligjore siç vijon “[n]ëse ai nuk mund të veproj në interes të klientit duke pasur parasysh punët dhe obligimet tjera, nëse ai mendon se nuk është kompetent ta përfaqësoj rastin, nëse ai konsideron se shansat për të fituar rastin janë të vogla, dhe nëse klienti i cili ka kërkuar ndihmë ligjore parashtron kërkesa të pakuptimta..”

¹⁵ Neni 29, Kodi i Etikës.

¹⁶ Për shembull, në një rast pronësor pranë Gjykatës Komunale në Viti, komuna në padi të datës 1 dhjetor 2004 kërkoi që i padituri ta liroj pronën kontestuese dhe të ja kthej atë komunës. I padituri nuk ishte në gjendje ta përfaqësoj vetveten. Pas dështimit që të merr pjesë në seancën e parë të mbajtur më 28 dhjetor 2005, në seancën e rradhës të mbajtur më 20 janar 2006, ai nuk ishte i aftë të shprehet në mënyrë të kuptueshme. Gjithashtu dukej se në këtë rast nuk kishte argumente që shkonin në favor të të paditurit. Gjykata me vendimin e saj të formës së prerë, vendosi në bazë të kërkesës së palës paditëse.

nuk i trajtojnë gjyqtarët dhe palët tjera me respektin e duhur. Në fakt, OSBE ka monitoruar raste ku gjatë seancave përgatitore dhe gjyqësore palët bërtitnin dhe ofendonin si njëri tjetrin ashtu dhe gjyqtarin.

Kjo parregullsi në seancat përgatitore dhe ato gjyqësore ndikon gjithashtu edhe në mbarëvajtjen e rasteve civile, duke shkaktuar shtyerje të shpeshta të cilat do të mund të shmangeshin po që se palët do të kuptonin rregullat procedurale civile. Si pasojë, mungesa e përfaqësuesve ligjor dhe ndihmës ligjore, në shumë raste civile ndikon negativisht në qasjen e palës në drejtësi si dhe u kontribuon vonesave të rasteve.

III. Autorizimet e pavlefshme për përfaqësim

Një fushë tjetër shqetësuese në lidhje me përfaqësimin ligjor në rastet civile ka të bëjë me kompetencat e avokatëve. OSBE ka monitoruar raste në të cilat avokati përfaqësoi palën mirëpo autorizimi më të anë të së cilit pandehte të veprj në të mirë të klientit (kompetenca e avokatit) nuk i plotësonte kërkesat ligjore ose ishte falsifikuar.¹⁷ Vlen të ceket se falsifikimi i autorizimeve të mbrojtësve shpesh ndodh në procedurat jo-kontestimore në rastet e vërtetimeve të transaksioneve pronësore. Këto raste zakonisht përfshijnë një person i cili vepron si përfaqësues ligjor i pronarit ose i blerësit.

Ligji mbi Bartjen e Pronës thotë “[n]jë kontratë në bazë të së cilës bartet e drejta për shfrytëzimin e pronës, apo posedim të pronës, duhet të përpilohet në formë të shkruar dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen në gjykatë.”¹⁸

Përderisa bazuar në Ligjin mbi Procedurën Jo-Kontestimore (LPJK),¹⁹ përfaqësuesi ligjor mund të përfaqësoj njëri nga palët të përfshira në transaksion pronësor,²⁰ gjyqtari do të zbuloj “nëse përfaqësuesi ose personi i autorizuar ka zotësinë e veprimit dhe nëse ai është i autorizuar të ekzekutoj marrëdhënien përkatëse ligjore.”²¹ Së fundi, Ligji mbi Kontratat dhe Detyrimet kërkon që “[f]orma e përshkruar [...] për kontratë apo ndonjë tjetër transaksion ligjor do të shfrytëzohet gjithashtu edhe autorizimin për të lidhur atë kontratë [...]”²²

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE ka vërejtur shfrytëzim të autorizimeve të pavlefshme për përfaqësim në transaksione të rrejshme pronësore ku përfshiheshin pronat e poseduara nga Serb të Kosovës të cilët ishin zhvendosur pas konfliktit dhe i

¹⁷ Shih *Shqyrtimin e Parë të Sistemit të Drejtësisë Civile* të OSBE-së, qershor 2006, fq 21, http://www.osce.org/documents/mik/2006/06/19407_alb.pdf

¹⁸ Neni 10.1, Ligji mbi Bartjen e Patundshmërisë (LBP) Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë, Nr. 15/74, 13 prill 1974, dhe Nr.14/77, 9 Prill 1977.

¹⁹ Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), Nr. 42/86, 24 tetor 1986.

²⁰ Shih Kapitullin XII, LPJK.

²¹ Neni 179.2, LPJK. Ligji mbi Vlefshmërinë e Nënshkrimeve dhe Duplikateve më tutje urdhëron që zyrtari i gjykatës të vërteton nënshkrimin e palëve apo të përfaqësuesve ligjor të tyre pasi që të jetë verifikuar origjinaliteti i tyre. Kjo bëhet përmes firmosjes së kontratës personalisht para zyrtarit të gjykatës dhe përmes pranimit që nënshkrimi në dokument përputhet me atë të palës. Për më tepër, personi i cili e sjell dokumentin për verifikim duhet të dëshmoj para gjykatës se ai ose ajo është autor/e e dokumentit (nenet 4.1 dhe 4.2). Nënshkrimi mund të vërtetohet vetëm kur zyrtari në gjykatë e njëj personalisht personin i cili kërkon vërtetimin, ose kur identiteti i tij/saj është konstatuar përmes prezantimit të letërnjoftimit. Kur personi nuk paraqet letërnjoftimin, verifikimi mund të bëhet edhe përmes dëshmisë së dy dëshmitarëve të rritur dhe të besueshëm, personalisht të njohur për zyrtarin në gjykatë ose identiti i të cilëve mund të verifikohet përmes letërnjoftimit (shih nenin 8).

²² Shih nenin 90, Ligji mbi Kontratat dhe Detyrimet, Gazeta Zyrtare RSFJ, Nr. 29/1978, 26 maj 1978.

kishin lënë pronat dhe posedimet e tyre në Kosovë. Nga mesi i vitit 2006, paditësit parashtruan padi nëpër gjykatat e Kosovës për 37 raste të pandehura të transaksioneve të rrejshme. Nga këto padi, 26 raste përfshinin pohime për autorizime të falsifikuara të avokatëve, dhe 11 raste përfshinin padi për kontrata të falsifikuara. Numri më i madh i rasteve vjen nga regjioni i Pejës me 14 raste nga Peja, 11 nga Klina dhe 1 nga Komuna e Istogut. Në mënyrë tipike, personi do ta falsifikonte letërnjoftimin e pronarit në mungesë dhe do ta përdorte dokumentin e falsifikuar për të përfituar autorizim ligjor për përfaqësim, të lëshuar jashtë Kosovës, dhe në rastet më të vonshme edhe në gjykata përbrenda Kosovës. Pas kësaj ai person, pronën në Kosovë ja shiste ndonjë personi tjetër. Gjatë këtij procesi, gjykata në territorin e së cilës gjendet prona, i vërtetonte këto transaksione pronësore të kryera bazuar në këto autorizime të pavlefshme. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

Më 19 shtator 2005, një Serbe e Kosovës parashtrroi një ankesë para Prokurorit Publik në Pejë kundër dy Shqiptarëve të Kosovës, duke i akuzuar ata se kanë falsifikuar letërnjoftimin e saj për të përfituar autorizim ligjor që ta shesin pronën e saj në Pejë. Më 21 shtator 2005 paditësja parashtrroi padi pronësore pranë Gjykatës Komonale në Pejë me të cilën kërkonte anulimin e kontratës për shitblerje me të paditurit - Shqiptarët e Kosovës, të cilën gjykata e kishte vërtetuar me 5 korrik 2005, sepse të paditurit kishin përdorur autorizim ligjor të falsifikuar. Ky autorizim ishte vërtetuar nga Gjykata Komonale në Mitrovicë më 9 qershor 2005 në bazë të letërnjoftimit të falsifikuar. Si dëshmi, paditësja prezantoi letërnjoftimin e vërtetë dhe atë të falsifikuarin i cili ishte përdorur për të vërtetuar autorizimin e përfaqësimit. Të dyja rastet ende mbeten të pazgjidhura para gjykatës.

Ngjashëm, në rastin e dytë pronësor pranë Gjykatës Komonale në Pejë një paditës – Serb i Kosovës, më 4 prill 2005 kërkoi anulimin e kontratës për transaksion pronësor të vërtetuar në Pejë më 6 tetor 2004 sepse e njëjta ishte e bazuar në një autorizim të pavlefshëm. Kontrata ishte lidhur në të mirë të shitësit nga një avokat i cili prezantoi një autorizim të vërtetuar pranë Gjykatës Komonale në Mitrovicë më 5 tetor 2004. Megjithatë, paditësi pandeh se ky avokat nuk ishte autorizuar kurrë që ta shes pronën. Rasti ende mbetet i pazgjidhur.

Në rastin e tretë pronësor, pranë Gjykatës Komonale në Istog, të datës 29 maj 2006, paditësi – Serb i Kosovës kërkoi anulimin e një kontrate pronësore e cila ishte vërtetuar para gjykatës së njëjtë më 19 maj 2006. Paditësi pohonte se të paditurit kishin falsifikuar letërnjoftimet e pronarëve të asaj prone (kushëri të paditësit) dhe bazuar në këto dokumente të falsifikuara ata kishin përfituar autorizim të pavlefshëm të vërtetuar pranë Gjykatës Komonale në Mitrovicë në të njëjtën datë, më 19 maj 2006. Si dëshmi, paditësi prezantoi certifikatën e vdekjes të njërit nga pronarët i cili kishte vdekur shumë përpara se kinse ta nënshkruaj autorizimin, si dhe letërnjoftimet e falsifikuara dhe ato të vërteta që i përkasin dy personave tjerë të cilët kinse e kishin nënshkruar autorizimin. Rasti ende mbetet i pazgjidhur.

Në rastin e katërt pranë Gjykatës Komonale në Vushtrri, më 24 janar 2006, katër Serb të Kosovës kërkuan anulimin e një transaksioni pronësor në mes të dy të paditurve – Shqiptarë të Kosovës (baba dhe bir). Gjykata vërtetoi

kontratën më 30 tetor 2003. Njëri nga të paditurit veptori si shitës i pronës bazuar në një autorizim nga pronarët, të vërtetuar kinse në Beograd, përderisa i padituri i dytë veptori si blerës. Paditësit pohonin se ky autorizim ishte i falsifikuar, sepse njëri nga personat i cili kinse e kishte nënshkruar atë, vdiq në vitin 2001. Veç kësaj, Gjykata e Parë Komunale në Beograd, më 26 prill 2006 konfirmoi se nuk e kishte vërtetuar autorizimin. Më 18 tetor 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri e shpalli vehten territorialisht jo-kompetente për ta vendosur rastin. Aktualisht rasti mbetet i pazgjidhur pranë Gjykatës Komunale në Pejë.

OSBE-ja është e brengosur se në dy rastet e para, avokatët ishin të përfshirë si përfaqësues ligjor në transaksione të rrejshme. Nëse avokatët vepruan në dijeni të fakteve, kjo jo vetëm që përbën vepër penale,²³ por gjithashtu shkel edhe detyrimet morale të avokatit, siç është të punojë në mënyrë profesionale, të qëndrojë lojal ndaj klientit dhe të veprojë me sinqeritet para organeve gjyqësore.²⁴ Në mbrojtje të gjyqësorit të Kosovës, kur të vërtetohet një transaksion pronësor ose autorizim, mund të jetë e vështirë që të zbulohen dokumentet e falsifikuara sepse ato vizuelisht mund të duken identike me dokumentet origjinale.²⁵ Megjithatë, në shembullin e katërt të lartpërmendur, transaksioni i rrejshëm do të mund të ishte ndaluar nga ana e gjykatës. Para se ta vërtetoj transaksionin, gjykata ka mundur të kërkoj nga Departamenti i Drejtësisë (DD) të konfirmoj se gjykata në Serbi paraprakisht kishte vërtetuar autorizimin.²⁶ Në mënyrë që t'i minimizoj vonesat, DD-ja duhet të shpejtoj procesin e kontrollimit se a janë valide autorizimet e lëshuara jashtë Kosovës.

Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara për të krijuar përshtypjen e përfaqësimit të autorizuar, është metoda primare e vërejtur nga OSBE-ja, e përdorur për të kryer transaksione të rrejshme në dëm të Serbëve të Kosovës. Kjo praktikë jo vetëm që është në kundërshtim me ligjin, por e pengon dhe deinkurajon kthimin e personave të

²³ Kjo mund të përbën vepër penale të mashtrimit bazuar në nenin 261, Ligji i Përkohshëm Penal i Kosovës (LPPK) dhe ose legalizim i përmbajtjes së falsifikuar, bazuar në nenin 334, LPPK.

²⁴ Shih veçanërisht nenet 3,4 dhe 5 të Kodit të Etikës.

²⁵ Në rastin pozitiv në vijim, Gjykata Komunale në Mitrovicë ia ka dalur të parandaloj një transaksion të rrejshëm pronësor: Më 20 tetor 2006, Gjykata Komunale e Mitrovicës refuzoi të vërtetoj një autorizim për përfaqësim në një transaksion pronësor. Edhe pse shitësi prezantoi një identifikim që dukej të jetë valid që tregonte emrin e pronarit të pronës, avokati i blerësit, gjatë një bisede në zyrën e gjykatës për regjistrim zbuloi se personi i cili prezantohej si pronar nuk i dinte detajet e rajonit përreth pronës, kështu që nuk kishte mundësi që ai të jetë pronari. Rasti menjëherë iu referua policisë për shkak të falsifikimit të mundshëm të identitetit. Rrjedhimisht, më 3 nëntor 2006 ishte ngritur aktakuza kundër tre Serbëve të Kosovës dhe një Shqiptari të Kosovës – avokat, për falsifikim dokumentesh, mashtrim (në tentativë) dhe/ose legalizim të përmbajtjes së falsifikuar. Më 19 shkurt 2007, Gjykata Komunale në Mitrovicë i dënoi tre Serbët dhe vendosi dënim me burg për shtatë muaj ndaj dy të akuzuarve, një vit dhe një muaj ndaj të akuzuarit të tretë, dhe avokatin Shqipëtar të Kosovës e liroi nga përgjegjësia penale.

²⁶ Si përgjigje ndaj numrit në rritje të transaksioneve të rrejshme në Kosovë, të kryera bazuar në fletë-autorizime të falsifikuara të cilat ishin vulosur nga gjykatat e Republikës së Serbisë dhe Malit të Zi bazuar në dokumente të falsifikuara, më 12 shkurt 2004 DD-ja kishte lëshuar një Memorandum të Brendshëm me të cilin udhëzonte gjyqtarët që të kërkonin nga palët të dëshmojnë se dokumentet e vulosura në gjykatat në Serbi dhe Mal të Zi nuk janë të falsifikuara. Verifikimi i origjinalitetit të këtyre autorizimeve do të duhej të bëhej nga ana e DD-së përmes komunikimit me Ministrinë e Drejtësisë në Serbi dhe Mal të Zi (Qarkoret e Drejtësisë DOJ/DIR/344/JH/04, dhe DOJ/LPD/0371/er/05). Megjithatë, ky Memorandum i Brendshëm adreson problemin e fletë-autorizimeve të falsifikuara të vulosura në gjykatat jashtë Kosovës, por jo edhe ato brenda saj.

zhvendosur si dhe krijon pengesa shtesë në zgjidhjen tashmë mjaft komplekse të situatës së pronës në Kosovë.

IV. Konfliktet e interesave dhe jo-përshtatshmëria e avokatëve

OSBE është e brengosur se rastet civile vazhdojnë të procedohen kur avokatët veprojnë si përfaqësues ligjor përkundër konfliktit të interesave, jo-përshtatshmërive që parandalojnë pavarësinë dhe aftësisë së tyre ta përfaqësojnë klientin në mënyrë efektive. Çfarë është edhe më shqetësuese, OAK-u nuk ndërmerr kurfarë masash disiplinuese.

Në bazë të Kodit të Etikës, me rastin e ushtrimit të ligjit avokati duhet t'i përfill të gjitha detyrimet morale.²⁷ Për shembull, avokati nuk do duhej ta përfaqësoj një klient në qoftë se e ka përfaqësuar një palë tjetër në po të njejtin rast.²⁸ Avokati gjithashtu i detyrohet klientit me lojalitet dhe fshehtësi. Kështu, pasi të ketë përfaqësuar një palë në një rast, avokati nuk mund që më vonë të ndërrohet dhe ta përfaqësoj palën tjetër në të njejtin rast, sepse kjo përbën konflikt të interesit i cili ndikon në detyrimet për lojalitet dhe fshehtësi që avokati ka ndaj klientit fillestar.²⁹

Veç kësaj, ushtrimi privat i ligjit është jokompatibil me punën në institucionet publike,³⁰ sepse kjo pozitë kompromiton pavarësinë e avokatit. Sipas Kodit të Etikës, "[n]ga avokati kërkohet që gjatë përfaqësimit, të jetë plotësisht i pavarur dhe i liruar nga çfarëdo presioni."³¹

Sa i përket procedurës interne disiplinuese për avokatët të cilët kanë kryer shkelje etike, të dyja si Ligji mbi Avokatinë ashtu edhe Statuti i OAK³² përcaktojnë së OAK-u duhet t'i disciplinoj avokatët të cilët kryejnë shkelje etike.³³ Megjithatë, përderisa këto ligje definojnë detyrimet morale dhe procedurat disiplinuese, ato nuk krijojnë ndonjë mekanizëm me anë të të cilit OAK-u do të njoftohej për shkelje të tilla. Rrjedhimisht, OAK-u mbështetet në ankesa të bëra nga akterët e jashtëm.³⁴ Edhepse

²⁷ Neni 1, Kodi i Etikës.

²⁸ Neni 27.1, Kodi i Etikës. Shih gjithashtu neni 17.1, Ligji mbi Avokatinë dhe Ndhimë tjetër Ligjore (Ligji mbi Avokatinë), Gazeta Zyrtare, KSAK Nr.43/73, 46/77 dhe 48/79, i cili thotë se "[n]jë avokat është i obliguar ta refuzoj klientin nëse në rastin e njejtë i ka dhënë ndihmë ligjore palës tjetër."

²⁹ Shih nenet 16-21, Kodi i Etikës.

³⁰ Neni 15.1, Kodi i Etikës i cili thotë "[p]rofesioni i avokatit është jokompatibil me profesionin e [...] punëtor në institucionet shtetërore." Shih gjithashtu neni 36 të Ligjit mbi Avokatinë, në bazë të së cilit të vetmit persona që nuk punojnë në institucionet publike kanë të drejtën të regjistrohen si avokatë pranë OAK-ut.

³¹ Neni 7, Kodi i Etikës.

³² Aprovuar nga Asambleja e OAK-ut më 27 tetor 2001.

³³ Neni 14, Ligji mbi Avokatinë thotë se "[a]vokatët do të mbahen përgjegjës përballë Odës së Avokatëve për çfarëdo shkelje gjatë ushtrimit të detyrës së tyre." Neni 49.1 thotë se "[v]endimet mbi përfundimin e së drejtës për të ushtruar avokatinë [njëri nga dënimet për shkeljen e Kodit të Etikës] do të merren nga Oda e Avokatëve." Neni 118.19, Statuti i OAK, e definojnë shkeljen e Kodit të Etikës si shkelje serioze e obligimeve të avokatëve, dhe nenet 117-150 numërojnë dënimet dhe procedurat e mundshme disiplinuese.

³⁴ Neni 126, Statuti i OAK thotë se "[P]rokurori disiplinues inicon procedurën disiplinuese bazuar në kërkesën e caktuar të bërë nga Këshilli Ekzekutiv, Kryetari i Odës, Kryetari i njëres nga takimet rajonale të Avokatëve dhe të bashkë-kryesuesve të Ministrisë së Drejtësisë." Kështuqë, përveç rasteve kur ndonjëri nga këta individ të përmendur njoftohet për ndonjë shkelje etike të kryer nga një avokat,

sa i përket përfaqësuesve ligjor, LPK vendosur disa obligime mbi gjykatat,³⁵ ligji në Kosovë nuk kërkon nga gjykatat që t'i raportojnë OAK-ut për shkelje etike të kryera nga avokatët. Nëse gjykata, pala, ose avokati nuk i raportojnë shkeljet etike, OAK-u nuk do inicoi procedurën disiplinuese. Aktualisht, OAK-u rrallë herë ndërmerr masa disiplinuese ndaj avokatëve për shkelje etike.³⁶

Përkundër këtyre obligimeve morale, OSBE ka vërejtur procedura gjyqësore në të cilat avokatët kishin konflikt interesash.

Më 7 mars 2006, Gjykata Komunale e Mitrovicës caktoi një avokat të vepror si përfaqësues i përkohshëm për një të paditur në mungesë. Më 13 qershor 2006, avokati barti autorizimin për përfaqësim të përkohshëm të të paditurit të një avokat tjetër i cili kishte përfaqësuar paditësin në fillim të rastit. Përkundër konfliktit të interesave, gjykata lejoi një ndërrim të tillë.

Përveç konfliktit të interesave, OSBE ka identifikuar gjithashtu edhe raste të mospërshtatshëm të avokatëve. Për shembull, avokatët e punësuar nga institucionet publike kanë përfaqësuar gjithashtu edhe palë private në gjykata.

Në raste të shumëfishta pranë Gjykatës Komunale në Pejë, avokati publik i komunës kishte përfaqësuar palë private. Kjo përbën shkelje etike sepse është jokompatibile të punohet si avokat që përfaqëson klientë privat si dhe për institucione publike.³⁷ Përkundër kësaj, (duke supozuar se avokati ishte i licencuar) OAK-u dështoi të ndërmerr masa disiplinuese dhe kështu avokati publik vazhdon të punoj privatisht.

Në përmbledhje, avokatët kanë vepruar në shkelje të pastërt të Kodit të Etikës si dhe gjykatat kanë dështuar t'i raportojnë OAK-ut mbi shkeljet etike. Për më tepër, OAK-u ka dështuar të ndërmerr masa disiplinuese kundër avokatëve të tillë.

V. Ushtrimi i dobët i detyrës nga ana e përfaqësuesve ligjor

Avokatët duhet t'i përfaqësojnë klientët me përkushtim, si dhe t'i mbrojnë interesat e tyre më së miri që të jetë e mundur. Kodi i Etikës, i cili gjithashtu rregullon

Prokurori Disiplinues nuk mund të inicoi procedurën kundër avokatit për të cilin pandehet se ka shkelur Kodin e Etikës.

³⁵ Për shembull, në bazë të nenit 98.4 të LPK-së “[g]jykata do të jetë nën obligim të siguroj se personi i cili paraqitet si përfaqësues është në të vërtetë i/e autorizuar ta përfaqësoj palën”, që do të thotë se gjykata duhet të kontrolloj validitetin e autorizimit të avokatit gjatë gjithë rrjedhës së procedurës. Bazuar në nenin 90.2, LPK, nëse gjykata gjen se përfaqësuesi është avokat mashtrues ajo do “[t]ë ja mohoj lejen për përfaqësim të mëtejshëm të palës dhe menjëherë ta njoftoj palën.” Neni 90 (4) thotë: “[n]ëse gjykata përcakton se përfaqësuesi i cili nuk është avokat dhe as nuk është i aftë ta ushtroj atë detyrë, gjykata do ta udhëzoj palën mbi pasojat e dëmshme që mund të paraqiten si rezultat i përfaqësimit jo të mirëfilltë”.

³⁶ Në vitin 2006, 14 raste i ishin referuar gjykatës disiplinuese të OAK-ut. Gjykata hodhi poshtë 12 raste duke mos gjetur baza mbi të cilat do të iniconte procedurë ndërsa në dy rastet tjera suspendoi avokatët. Të dyja këto raste ishin raportuar nga ana e gjykatave (shpërdorim i detyrës zyrtare).

³⁷ Në një rast, avokati publik përfaqësoi një paditës privat kundër Komunës si palë e paditur që në të njëjtën kohë është punëdhënësi i tij, duke ngritur kështu çështjen jo vetëm të jokompatibilitetit por edhe të konfliktit të interesave.

marrëdhëniet në mes të mbrojtësit dhe klientit,³⁸ thotë “[a]vokati e këshillon dhe e mbron klientin e tij me zell dhe përkushtim,”³⁹ dhe parasheh që “[a]vokati duhet të siguroj që t’i ofroj palës së vet mbrojtje të nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur dhe me sa më pak shpenzime që të jetë, si dhe t’i kundërvihet çfarëdo vonese.”⁴⁰ Së paku, avokati duhet t’i përfill përkushtimisht rregullat procedurale të vendosura sipas ligjit të aplikueshëm si dhe ta mbroj klientin.

Përkundër këtyre kërkesave për përfaqësim ligjor efektiv, diligent dhe me përkushtim,⁴¹ OSBE ka vërejtur ushtrim të dobët detyrash nga disa avokatë. Shqetësimet kryesore përfshijnë dështimin e avokatëve të marrin pjesë në seanca gjyqësore pa njoftuar paraprakisht gjykatën. Veç kësaj shumë avokatë dështojnë t’i përfillin kufizimet kohore për procedurat gjyqësore. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

Në një rast pranë Gjykatës Komonale në Pejë, avokati dështoj të merr pjesë në disa seanca të shqyrtimit kryesor. Avokati nuk e njoftoi me parë gjykatën apo palët tjera dhe nuk dha kurfarë arsytimi mbi mungesën e tij. Kjo sjellje jo e ndershme shkaktoi shumë shtyrje dhe rezultoi me vonesa të panevojshme. Përderisa avokati nuk vuajti pasoja për veprimet e tij, gjykata e dënoi klientin dhe e detyroi atë që të paguaj shpenzimet procedurale të cilat rezultuan nga mungesa e avokatit.

Në një rast prone pranë Gjykatës Komonale në Vushtrri, pasi që avokati i paditësit nuk u shfaq në seancën e dytë të shqyrtimit kryesor të caktuar për 13 qershor 2005, gjykata e shtyu procedurën për tre muaj. Avokati më vonë pandehi se kishte qenë i angazhuar në një rast tjetër pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe se, përkundër dërgesës së këtij informacioni, “informata kishte arritur vonë në këtë gjykatë.” Pas dy seancave të caktuara për shqyrtim kryesor, avokati i paditësit prapë kishte dështuar të shfaqet më 20 janar 2006, dhe gjykata suspendoi procedurën për të dytën herë.

³⁸ Shih Kapitullin III, Kodi i Etikës.

³⁹ Neni 32, Kodi i Etikës.

⁴⁰ Neni 50, Kodi i Etikës.

⁴¹ Praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka përcaktuar se caktimi i mbrojtësit sipas detyrës zyrtare – nëse nuk përbën mbrojtje efektive – nuk e përmbush *per se* kërkesën e ndihmës juridike falas kur ajo kërkohet. Në rastin *Bertuzzi kundër Francës*, aplikuesit i ishte njohur e drejta në ndihmë ligjore që të sjell rastin kundër një avokati, por secili nga avokatët u tërhoq me arsyetim se e njihnin avokatin. GjEDNj gjeti se gjykata është dashur të sigurojë që aplikuesit të pranoi ndihmë efektive (*Bertuzzi kundër Francës*, GjEDNj, 13 shkurt 2003, Para. 24 ff). Në rastin penal *Daud kundër Portugalisë*, GjEDNj tha se “caktimi i mbrojtësit vetvetiu nuk siguron efektshmërinë e ndihmës ligjore të cilën ai si i akuzuar do të duhej ta pranonte.” (*Daud kundër Portugalisë*, GjEDNj, 21 prill 1998, Para. 38). Edhe pse, si anëtarë të profesionit, avokatët janë të pavarur në ushtrimin e detyrave të veta, GjEDNj ka nënvizuar shkelje të nenit 6.3 c) të KEDNj-së për rastet ku aplikuesit ishin ankuar në pamjaftueshmërinë e ndihmës ligjore të ofruar nga mbrojtësit e caktuar *ex officio*. Në këtë kontekst, GjEDNj tha se “(s) ipas Nenit 6.3 c) autoritetet kompetente nacionale janë të obliguara të intervenojnë vetëm në qoftë se dështimi i mbrojtjes ligjore për të ofruar përfaqësim efektiv është evident apo ka tërhequr vëmendjen e tyre në ndonjë mënyrë tjetër. (*Czekalla kundër Portugalisë*, GjEDNj, 10 tetor 2002, Para. 60). Sa i përket rrethanave të konsideruara si “dështime evidente” për ofrim të ndihmës ligjore efektive, GjEDNj ka paraparë parashtrimin e ankesës pa zbatim të kërkesave formale nga ligji vendor dhe mungesës së kontaktit në mes të mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare dhe klientit të tij për më shumë se të tre muaj që kur janë shfaqur mangësitë evidente nga ana e mbrojtësve të caktuar sipas detyrës zyrtare. (Shih vendimet e GjEDNj-së në rastet *Czekalla kundër Portugalisë*, Para. 62 ff dhe respektivisht *Daud kundër Portugalisë*, Para. 42).

Në rastin e tretë, pagesë e borxhit, e mbajtur pranë Gjykatës Komunale në Prizren, më 20 nëntor 2003, procedura kishte pësuar vonesë për shkak se avokati i paditësit nuk kishte ardhur në seancën gjyqësore të 19 majit 2006, pa japur aryetimm dhe kështuqë gjykata e shtyu gjykimin për kohë të pacaktuar. Gjykata e mbajti seancën tjetër të shqyrtimit kryesor më 15 nëntor 2006, gati gjashtë muaj pas asaj séance.

Në rastin e katërt pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë, në seancën dëgjimore përgatitore të mbajtur më 13 janar 2004, avokati i të paditurit deklaroi se kishte për qëllim të parashtrijë në padi, gjë për të cilën gjykata vendosi një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se avokati, në seancën e radhës që ishte caktuar për një muaj më vonë, ende nuk kishte parashtruar përgjigje në padi, gjykata e shtyu seancën.

Ngjashëm, avokatët nuk kishin përfaqësuar denjësisht klientët e tyre dhe në këtë mënyrë bënë shkelje të rregullave procedurale të LPK-së, duke parashtruar padi pa dëshmi mbështetëse dhe duke dështuar të prezantojnë dëshmi të reja të cilat do t'i zhvleftësonin dëshmitë e palës tjetër.⁴² Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

Rasti i parë ka të bëjë me një kontest rreth ndarjes së pasurisë që pasoi rastin e shkurorëzimit pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Edhe pse avokati i paditësit në parashtrësën e tij të datës 20 shtator 2005 kërkoi kthimin e gjësendeve të blera kinse gjatë martesës, ai dështoi të ofrojë çfarëdo dëshmie si bazë për padi. Pasi që në seancën e parë të shqyrtimit kryesor avokati nuk kishte prezantuar kurfarrë dëshmie, gjyqtari e shtyu seancën dhe urdhëroi avokatin e paditësit ta preçizoi më shumë padinë dhe të ofroj dëshmi mbështetëse. Në seancën e radhës, avokati kishte dështuar të ndryshojë padinë ose të prezantojë dëshmi por kërkoi shtyrje e cila edhe u aprovua. Kur edhe në seancën e tretë avokati nuk kishte përfillur urdhërin e gjykatës për ta preçizuar padinë, gjykata prapë e shtyu seancën.

Në rastin e dytë pranë Gjykatës Komunale në Skenderaj që përfshinte një padi për kompensim dëmi, të datës 1 nëntor 2004, avokati i të paditurit, në seancën e mbajtur më 11 janar 2005 sfidoi një ekspertizë që kishte të bënte me sasinë e dëmit që kishte pësuar paditësi, mirëpo dështoi të ofrojë dëshmi që do të kishte zhvleftësuar raportin e ekspertit.⁴³ Rrjedhimisht, duke u bazuar në ekspertizë, gjykata pranoi rekomandimet lidhur me sasinë e dëmit.

⁴² Neni 186.1, LPK urdhëron që “[p]adia duhet të përmbajë [. . .] çështjen parësore dhe [...] faktet mbi të cilat paditësi bazon padinë, dëshmitë që provojnë ato fakte dhe të gjitha informacionet tjera që secila parashtrësë duhet t’i ketë.” Neni 7.2, LPK thotë që “[p]alët duhet të prezantojnë të gjitha faktet mbi të cilat janë të bazuara paditë e tyre dhe të ofrojnë dëshmi për mbështetjen e këtyre fakteve.” Neni 219, LPK nënvizon se “[s]ecila palë është e obliguar të prezantojë fakte dhe propozojë dëshmi mbi të cilat pala e mbështet padinë e vet ose konteston deklaratat dhe dëshmitë e palës kundërshtare.”

⁴³ Nën nenin 261, LPK, mendimet e ekspertëve tjerë do të kërkohen, “nëse gjinden kundërthënie ose gabime në mendimet e njërit apo më shumë dëshmitarëve ekspert, ose dyshim i arsyeshëm në parregullësinë e mendimit të dhënë, dhe se ky dyshim e këto gabime nuk mund të largohen duke ridëgjuar dëshmitarin ekspert...”

Një tjetër shqetësim i raportuar më parë nga OSBE⁴⁴ është performimi i dobët i avokatëve të caktuar si përfaqësues të përkohshëm për klientët në mungesë.⁴⁵ Në shumë raste të monitorurara, përfaqësuesit e përkohshëm ishin pasiv gjatë procedurës dhe dështuan që në mënyrë të duhur t'i mbrojnë interesat e klientëve në mungesë.

Edhe pse është vështirë për përfaqësuesit e përkohshëm të prezantojnë dëshmi të reja kur pala mungon, në rastet e vëzhguara nga OSBE, përfaqësuesit e përkohshëm shumë shpesh nuk i shqyrtonin në mënyrë të duhur si dhe nuk i sfidonin dëshmitë e propozuara dhe të prezantuara nga pala kundërshtare. Në vend të kësaj, përfaqësuesit e përkohshëm deklarorin në mënyrë tipike, se gjykata duhet ta vendos rastin në bazë të ligjit dhe dëshmimeve. Edhe më shqetësuese është se, në disa raste përfaqësuesi i përkohshëm sugjeronte që rasti të vendoset në dëm të klientit të vet, duke shkelur kështu parimin e mbrojtjes së denjë. Rastet në vijim shërbejnë si shëmbuj:

Në një rast prone pranë Gjykatës Komunale në Gjilan, më 10 janar 2005 paditësi kërkoi nga gjykata që ajo të vërtetojë pronësinë e tij për një banesë, bazuar në një kontratë e cila nuk ishte e vërtetuar në gjykatë. Dëshmitari i vetëm i paditësit i cili konfirmoi ekzistencën dhe kushtet e kontratës, dha dëshmi kontradiktore lidhur me datën e firmosjes së kontratës. Dëshmitari gjithashtu deklaroi se kontrata ishte shkruar me makinë shtypi, edhe përkundër asaj se kontrata e prezantuar, në mënyrë evidente ishte shtypur nga kompjuteri. Përkundër këtyre kundërthënieve përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit në mungesë nuk e morri ne pyetje dëshmitarin. Edhe më shumë shqetësuese është se, përfaqësuesi i përkohshëm në fjalën e vet përfundimtare tha se dëshmia vërtetoi padinë e palës kundërshtare.

Në rastin e dytë pronësor pranë Gjykatës Komunale në Gjilan, më 20 qershor 2005 paditësi kërkoi që gjykata ta vërtetojë pronësinë e tij mbi ngastrën kontestuese duke pohuar se në vitin 1997 ai kishte blerë pronën nga i padituri Serb i Kosovës i cili tani mungon. Si dëshmi e vetme në mbështetje të padisë ai prezantoi një dëshmitar i cili konfirmoi lidhjen e kontratës, përderisa në fletën poseduese i padituri ishte ende i regjistruar si pronar. Përkundër kësaj dëshmie të dobët të ofruar nga paditësi në mbështetje të padisë, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit sugjeroi që gjykata të vendos në të mirë të paditësit sepse dëshmia provoi që palët kishin lidhur kontratë mbi transaksion pronësor.

Në një tjetër rast prone pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë, paditësi-Shqiptar i Kosovës, më 3 mars 2006 kërkoi që gjykata ta vërtetojë pronësinë e tij mbi pronën kontestuese, bazuar në një aktvendim të Gjykatës Komunale të Mitrovicës që datonte nga viti 1987, i cili konfirmonte se paditësi kishte blerë pronën nga një Serb i Kosovës në vitin 1987. Megjithatë, eksperti i gjeodezisë konfirmoi se i padituri Serb i Kosovës i cili mungon, aktualisht figuron ne listën poseduese si pronar i pronës kontestuese. Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit nuk e ngriti argumentin e rëndësishëm që ka të bëjë me atë se të drejtat pronësore mund të kenë ndërruar pas 1987-ës, por në mënyrë pasive deklaroi se gjykata duhet të vendos në bazë të dëshmimeve të prezantuara. Vetëm pala e tretë, i cili ju bashkangjiti procedurës - një fqinj i të paditurit, deklaroi në

⁴⁴ Shih Raportin e Shkurtë të OSBE-së mbi *Caktimin e Përfaqësuesve të Përkohshëm* (prill 2005) dhe *Shqyrtimin e Parë të Sistemit të Drejtësisë Civile* (qershor 2006), *supra* foosnota 20, faqe 6.

⁴⁵ Neni 84, LPK.

të mirë të të paditurit bazuar në faktin se ky i fundit është i regjistruar si pronar në listën poseduese.

Këta shembuj tregojnë se shpesh përfaqësuesit e përkohshëm nuk i përfaqësojnë klientët e tyre në mënyrë të duhur, duke shkelur kështu Kodin e Etikës, ligjin vendor dhe kushtimisht edhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Mbrojta efektive është veçanërisht e rëndësishme kur pala mungon ose nuk është në dijeni për procedurën gjyqësore. Kështuqë, avokatët duhet të vëprojnë me kujdes, në mënyrë të denjë dhe profesionale, sidomos në rastet ku përfshihen përfaqësuesit e përkohshëm të palësve në mungesë.

VI. Përfundim

Avokatët mund të luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e sundimit të ligjit. Ata duhet të mbrojnë interesat e klientëve të tyre dhe mund të ndihmojnë të sigurohet që anëtarët e tjerë të gjyqësorit – siç janë gjyqtarët dhe prokurorët – përfillin ligjin. Ky raport fillimisht trajton çështjet më të përgjithshme dhe strukturale që ndërlidhen me avokatët, siç është mungesa e një sistemi funksional për ndihmë juridike si dhe shfrytëzimi i autorizimeve të pavlefshme të avokatit. Megjithatë, mbulon edhe probleme më specifike që kanë të bëjnë me përfaqësim ligjor individual siç janë shkeljet e Kodit të Etikës përmes konfliktit të interesave, mos përshatshmërisë dhe ushtrimit të dobët të detyrës. Pasi që avokatët janë pjesë integrale e sistemit të drejtësisë në Kosovë, këto shkelje të Kodit të Etikës, ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duhet të korrigjohen.

VII. Rekomandime

Për avokatët:

- Avokatët tashmë të angazhuar në rastet e ndihmës juridike duhet të vazhdojnë që *pro bono* të përfaqësojë klientët e tyre ose, t'i japin fund përfaqësimit bazuar në Kodin e Etikës dhe ligjin vendor.
- Avokatët duhet të marrin pjesë në seanca dëgjimore ose paraprakisht ta aryetojnë mungesën e tyre dhe të ja komunikojnë atë gjykatës dhe palëve.
- Avokatët duhet ta përfillin Kodin e Etikës, t'ju shmangen konfliktit të interesave dhe jo-përshatshmërive, si dhe duhet t'i përfaqësojnë klientët e tyre me përkushtim të duhur.

Për Odën e Avokatëve të Kosovës:

- Të sigurojë që anëtarët e licencuar të OAK të mos punojnë në të njëjten kohë si avokat publik komunal.

- Të ndërmerr masa disiplinuese kundër avokatëve të cilët shkelin Kodin e Etikës si përmes konfliktit të interesave, mos-përshtashmërive ose ushtrimit të dobët të detyrave.
- T'i ofrojë anëtarve të vet arsimim të vazhdueshëm ligjor mbi Kodin e Etikës.

Për gjyqtarët:

- Të sigurojnë përfaqësim të duhur dhe efektiv për palët, në veçanti kur pala mungon ose nuk është i/e aftë ta përfaqësoj vetven në mënyrë të duhur.
- Të verifikojë vlefshmërinë e autorizimit të avokatit të prezantuar para gjykatës si në procedurën kontestimore ashtu edhe në atë jo-kontestimore.
- Kurdo herë që gjykata jashtë Kosovës të ketë vërtetuar autorizimin e avokatit, të kontrollojë origjinalitetin e tij përmes procedurës të përcaktuar nga DD, veçanërisht në qoftë se pala e përfaqësuar mungon.
- T'i raportojë OAK-ut për shkeljet e Kodit të Etikës të kryera nga avokatët, siç janë konflikti i interesave, ushtrimi i dobët i detyrave apo jo-përshtashmëritë.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:

- Të organizoj seanca trajnuese për gjyqtarët mbi detyrimet morale të avokatëve, në veçanti për ato që lidhen me konfliktin e interesave dhe jompatibilitetet.

Për autoritetet tjera në Kosovë:

- Zyra e Kryeministrit të Kosovës duhet t'i zgjedh anëtarët e Komisionit për Ndihmë Ligjore sa më parë që të jetë e mundur dhe të sigurojë themelimin dhe caktimin e personelit për të gjitha organet e sistemin për ndihmë juridike të parapara me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/36 mbi Ndihmë Ligjore.
- Kuvendet komunale në Kosovë duhet të ofrojnë hapësirë për zyrat rajonale për ndihmë ligjore.
- Pasi të themelohen, Komisioni për Ndihmë Ligjore, Zyra Koordinuese për Ndihmë Ligjore dhe Zyra e Qarkut për Ndihmë Ligjore duhen të mbështeten nga UNMIK-u ose pasardhësi i tij, autoritetet Kosovare dhe donatorët tjerë përmes projekteve për ndërtim kuadrosh dhe konsultatntëve ekspert.

